

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYËSORË PRIVATË
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE SH.P.K

NIPT L71710039A

Nr. 1098 Regj
Nr. 418 Prot

Tiranë, më 27.01.2020

URDHER

“PËR ZBATIMIN E MARREVESHJES SIGURUESE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit
Adresa: Tirane

Per djene: Debitorit, “Loresa” Shpk Nipt L52423020A
Adresa: Blv. Bajram Curri, Qendra ETC, Ap.14/7, Tirane
Per djene: Debitorit, Itan Hoxha dtl.04.04.2007
Adresa: Rr. Pavaresia, Kashar, Nr.39, (Digit-Alb Sh.a), Tirane,
Per djene: Debitorit, Redia Hoxha dtl.15.02.1998
Adresa: Rr. Pavaresia, Kashar, Nr.39, (Digit-Alb Sh.a), Tirane,
Per djene: Kreditorit, “A.I.B.A Kompani” Sh.a J61818528J
Adresa: Rr. Tirana, Lagjia 13, Shkozet, Durres
Per djene: Kreditorit, Alba Gina dtl.14.04.1977
Adresa: Rr. Themistokli Germenji, Nr.2, Tirane,
Per djene: Kreditorit, Agim Zeqo dtl.26.08.1968
Adresa: Rr. Dhaskal Todhri, Nr.35, Kashar, Tirane,

Unë, Resul Alushani, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë “ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 1427 Akti të lëshuar më datë 23.01.2020 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1098, Datë 24.01.2020 kërkesën e kreditorëve “A.I.B.A Kompani” Sh.a; Alba Gina dtl.14.04.1977 dhe Agim Zeqo dtl.26.08.1968, ndaj debitorëve Shoqëria “Loresa” Shpk, Itan Hoxha dhe Redia Hoxha, perfaqesuar me Prokure te Posacme Nr.254 Rep. Nr.77 Kol. Date 22.01.2020 nga Av. Jeronima Lulashi, në lidhje me titullin ekzekutiv “Marreveshje Siguruese” Nr. 4848 Rep. Nr. 2737 Kol. datë 18.12.2015.

KONSTATOVA:

Debitorët “Loresa” Shpk, Itan Hoxha dhe Redia Hoxha, nuk kane permbushur detyrimet sipas “Marreveshje Siguruese” Nr. 4848 Rep. Nr. 2737 Kol. datë 18.12.2015.

Barredhenesi Sara Hoxha nepermjet Kontrates se Dhurimit te aksioneve Nr.68Rep Nr.25Kol date 28.01.2016, te gjithë aksionet qe zoteronte ja ka kaluar shoqerise “LORESA”sh.p.k, ku sot rezulton 50% ortake e saj. Me realizimin e ketij transferimi, shoqeria “LORESA”sh.p.k, ka marre persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe Sara Hoxha ka pasur ne cilesine e aksioneres si individ ne Digitalb, ne baze te nenit 2.1 paragrafi 3 te kontrates, si dhe nepermjet Deklarates Noteriale Nr.68/25 date 28.01.2016 cilesohet se marrin persiper barren siguruese sipas Marreveshjes Kuader.

Barredhenesit Alban Jaho, Enkelejdi Joti, Eduart Poda, “Dem Capital” shpk, E & E Investment shpk dhe “Union Distribucion Servis Albania” shpk, kane permbushur vullentarisht detyrimet sipas marreveshjes siguruese.

Barremarresi Samir Mane, nepermjet "Marreveshje Cedimi te drejtash mbi aksionet Digit-alb..." date 09.01.2020, ka hequr dore nga perfitimi i 1.47% te aksioneve qe do te perfitonte ne baze te marreveshjes siguruese nga pala debitore, duke e transferuar kete te drejte ne favor te "A.I.B.A KOMPANI" sh.a.

Gjykata e rrethit Gjyqësor Tirane me Vendimin Nr. 1427 Akti date 23.01.2020, ka vendosur: "...Leshimin e urdhrat te ekzekutimit per titullin ekzekutiv Marreveshje Siguruese me Nr.4848 Rep. Nr.2737 Kol. Date 18.12.2015, nenshkruar perpara noterit publik Mimoza Sadushaj, dhe sekuestrimin e aksioneve te Shoqerise "Digitalb" Sh.a te percaktuar nga marreveshja siguruese dhe kalimin e tyre ne emer te barremarresve kerkues sipas percaktimit te kesaj Akti Marreveshje Siguruese..."

Ne zbatim te Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 1427 Akti të lëshuar më datë 23.01.2020 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, leshuar per titullin ekzekutiv "Marreveshje Siguruese" Nr. 4848 Rep. Nr. 2737 Kol. datë 18.12.2015, nga ana e Ekspertit Kontabel jane bere perlllogaritje konkrete te aksioneve qe do te transferohen, te cilat i jane vene ne dispozicion permblyesit gjyqësor nepermjet aktit te ekspertimit perkates date 24.01.2020.

Sa më sipër, si dhe ne zbatim te dispozitave te K. Pr. Civile, Ligjit Nr. 26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat" dhe Neni 31 e vijues te Ligjit Nr. 8537 date 18.10.1999 "Per Barret Siguruese",

URDHËROJ:

1. Sekuestrimin e 0.53% te aksioneve te Shoqerise "LORESA" sh.p.k, me numer aksione 1219.40 dhe kalimin ne favor te secilit perfitues, ne kete menyre:
 - Ne favor te Shoqeria "AIBA KOMPANI" sh.a, te transferohet 0,37% te aksioneve me numer aksione 829.19;
 - Ne favor te zj. Alba Gina, te transferohet 0,07% te aksioneve me numer aksione 170.72;
 - Ne favor te z. Agim Zeqo, te transferohet 0,10% te aksioneve, me numer aksione 219.49;**Debitori "LORESA" Shpk, perfundimisht pas transferimit do te zoteroje 30.07% te aksioneve, me numer aksione 69,182.**
2. Sekuestrimin e 1.63% te aksioneve te Itan Hoxha, me numer aksione 3,750.24 dhe kalimin ne favor te secilit perfitues, ne kete menyre:
 - Ne favor te Shoqeria "AIBA KOMPANI" sh.a, te transferohet 1.11% me numer aksione 2,550.16;
 - Ne favor te zj. Alba Gina, te transferohen 0,23% te aksioneve me numer aksione 525.03;
 - Ne favor te z. Agim Zeqo, te transferohen 0,29% te aksioneve, me numer aksione 675.04;**Debitori Itan Hoxha perfundimisht pas transferimit do te zoteroje 8,56% te aksioneve, me numer aksione 19,717.**
3. Sekuestrimin e 6% te aksioneve te Redia Hoxha, me numer aksione 13,804.56 dhe kalimin ne favor te secilit perfitues, ne kete menyre:
 - Ne favor te Shoqeria "AIBA KOMPANI" sh.a, te transferohet 4,08% me numer aksione 9,387.1;
 - Ne favor te zj. Alba Gina, te transferohet 0,84% te aksioneve me numer aksione 1,932.64;
 - Ne favor te z. Agim Zeqo, te transferohen 1,08% te aksioneve, me numer aksione 2,484.82;**Debitori Redia Hoxha perfundimisht pas transferimit do te zoteroje 4,19% te aksioneve me numer te aksione 9.663 .**
4. Pas transferimit te aksioneve sipas pikave 1,2 dhe 3, kreditorët/perfituesit do te zoterojne ne shoqerine "Digit-Alb" Sha, respektivisht:

- “AIBA KOMPANI” Sh.a, do te zoteroj gjithsej 9,23% te aksioneve qe korespondon 21,234 numer aksione;
 - ALBA GINA, do te zoteroj gjithsej 2,17% te aksioneve qe korespondon 4.999 numer aksione;
 - AGIM ZEZO, do te zoteroj gjithsej 2,79% te aksioneve qe korespondon 6.428 numer aksione;
5. Pala debitore ka detyrimin te paguaje tarifën e shërbimit përmbarimor, në vlerën prej 1,351,742 (një milion e treqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dyzetë e dy) Lekë me TVSH.
 6. Për veprimin apo mosveprimin tuaj duhet te na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
 7. Per personat që bëhen pengesë ne zbatimin e ketij urdhri do të merren te gjitha masat e parashikuara ne neni 606 e në vijim te K.Pr.Civile, si dhe ne rast se ka vend do te kerkohet ndjekje penale ne baze te dispozitave te Kodit Penal.
 8. Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat ne baze te nenit 610 te K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqesor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

“REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k

PËRMBARUESI GJYQËSOR

Resul ALUSHANI

